



Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), nenin 50 i Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative (Ligji Nr. 05/L -031 25 maj 2016) KSHC mori:

V E N D I M

Për korrigjimin (përmirësim) e vendimit të KSHC-së Nr.828/15, datë 15.08.2015

1. Korrigjohet (përmirësohet) vendimi i KSHC-së Nr.828/15, datë 15.08.2015 i Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në pikën I.
2. Korrigjohet (përmirësohet) pika I, e vendimit të KSHC -së Nr. 828/15, datë 15.08.2015, si në vijim: Përmirësohen të gjitha gradat shkencore të programeve të studimit nga BA, në BSc, dhe nga MA në MSc. Riakreditohen programet e studimit:
 - Banka, Financa dhe Kontabilitet, BSc, (180 ECTS);
 - Banka, Financa dhe Kontabilitet, MSc, (120 ECTS);
 - Menaxhment dhe Informatikë, BSc, (180 ECTS);
 - Menaxhment dhe Informatikë, MSc, (120 ECTS);
 - Marketing, BSc, (180 ECTS);
 - Marketing, MSc, (120 ECTS);
 - Ekonomiks, BSc, (180 ECTS);
 - Ekonomiks, MSc, (120 ECTS);
 - Kontabilitet, BSc, (180 ECTS), dhe
 - Ndërmarrësi dhe zhvillim lokal, MSc, (120 ECTS).
3. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së Nr. 828/15, datë 15.08.2015, mbetet e pa ndryshuar.
4. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.


Arsyetimi

Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" ka parashtruar kërkesë (nr. 1285/18H, datë 08.10.2018) për përmirësim të vendimit të KSHC-së Nr. 828/15, datë 15.08.2015, në pikën I. Bazuar në kërkesën e cekur më sipër, dhe nenin 50 të Ligjit mbi procedurën e përgjithshme administrative (Ligji Nr. 05/L -031 25 maj 2016), Agjencia e Kosovës për Akreditim ka trajtuar kërkesën në fjalë, dhe pas kontrollimit në detaje të aplikacionit e parashtruar nga Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" për ri-akreditim të programeve të studimit të cekura më sipër dhe Raportit Final të ekspertëve të cilët kanë vlerësuar programet e studimit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (tash e tutje LPPA) nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti Ekonomik;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

